



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/2020

FTESA PER OFERTE

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Adresa Rruga “Vilat Gjermane” Vila Nr. 5 Tiranë – Shqipëri
Tel/Fax 069926867
Personi Përgjegjës vvasiari@adfd.al
 jbebeci@adfd.al
 mmulita@adfd.al
Adresa e Internetit www.adfd.al

REF-69868-08-26-2020

Autoriteti Kontraktor, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shërbim promovimi digjital”, nëpërmjet rrjeteve sociale nderkombetare, me specifikat si me poshte vijon:

Data e zhvillimit të tenderit do të jetë **27/08/2020 ora 16:00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me të dhënat si më poshtë:

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në kuadër të zbatimit të projektit “Diaspora për Zhvillim”, të miratuar me VKM Nr.611, datë 17.10.2018 është duke zhvilluar aktivitetet:

- *Krijimi i Rrjetit të Profesionistëve në Diasporë, aktiviteti 2*
- *Si të fillosh një biznes në Shqipëri, aktiviteti 4*
- *Digjitalizimi i veprave shqiptare, aktiviteti 5*

Këto aktivitete, midis të tjerash, kanë pjesë përbërëse të tyre edhe 3(tre) platforma elektronike, si produkte që mundësojnë komunikimin dhe ndërveprimin me grupet e synuara të projektit, të cilët ndodhen jashtë vendit. Aktualisht platformat janë të publikuara, të pasuruara më informacion dhe operojnë prej disa muajsh. Me qëllim rritjen e numrit të përfituesve të projektit, përhapjen e informacionit te palët e interesit, si edhe nisur nga mungesa e kontaktit dhe takimet fizike me ta, nevojitet promovimi i platformave në rrjete sociale nëpërmjet fushatave të marketingut digjital.

Për këtë arsye, për të rritur shikueshmërinë e aktiviteteve online që FSHZHD ofron nëpërmjet platformave elektronike, si dhe për të rritur komunikimin me Shqiptarët në Diasporë, kërkohet **zhvillimi dhe menaxhimi i fushatave promovuese**, nëpërmjet kanaleve të komunikimit digjital që FSHZHD zotëron, me specifikime si më poshtë:

AUDIENCA 1 , në kuadër të Aktivitetit 2 & Aktivitetit 5	
Vendodhja:	Evropë, Kanada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Gjinia:	Femra & Meshkuj
Mosha:	18-64 veje
Karakteristika demografike	Industria: IT, Administratë, Arkitekturë & Inxhinieri, Arte, Sport, Media, Shërbime Sociale, Matematikë & Informatikë, Edukim, Shëndetësi, Ligj, Menaxhim.

Audienca 1 do të targetohet për fushatat si vijon:

FUSHATA PËR AUDIENCËN 1	
Fushata 1	
Objektivi specifik i fushatës & lloji	Rritja e klikimeve në website nëpërmjet rrjeteve sociale nderkombetare.
Përmbajtja	Tekst & foto
Kohëzgjatja	15 ditë në total
Klikime totale të përfituara në website	Min. 30.000 klikime
Fushata 2	
Objektivi specifik i fushatës & lloji	Rritja e numrit të ndjekësve në rrjetet sociale nderkombetare.
Përmbajtja	Tekst, Foto, Link
Kohëzgjatja	10 ditë në total
Ndjekës të përfituar	Min 2000 ndjekës të shtuar

AUDIENCA 2, në kuadër të Aktivitetit 4	
Vendodhja:	Evropë, Kanada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Gjinia:	Femra & Meshkuj
Mosha:	18-64 vjeç
Karakteristika demografike	Punësimi: Administrator Biznesi, Drejtor, Menaxher, CEO, Pronar
Interesa	Biznes & Industri; Diaspora Shqiptare
Shtetësia	Shqiptare

Audienca 2 do të targetohet për fushatat si vijon:

FUSHATA PËR AUDIENCËN 2	
Fushata 1	
Objektivi specifik i fushatës & lloji	Rritja e klikimeve në website nëpërmjet rrjeteve sociale nderkombetare
Përmbajtja	Tekst, Foto, Link dhe video
Kohëzgjatja	10 ditë në total
Klikime totale të përfituara në ëebsite	Min. 3000 klikime
Fushata 2	
Objektivi specifik i fushatës & lloji	Mbledhja e kontakteve të investitorëve potencialë
Përmbajtja	Formular
Kohëzgjatja	10 ditë në total
Shikushmëria totale (reach)	Min. 30,000 individë
Fushata 3	
Objektivi specifik i fushatës & lloji	Rritja e numrit të ndjekësve në kanalet e komunikimit, ne rrjetet sociale nderkombetare.
Përmbajtja	Linku i profilit të faqes
Kohëzgjatja	10 ditë në total
Ndjekës të përfituar	Min 1000 ndjekës të shtuar

Shërbimi nevojitet të realizohet deri në Dhjetor 2020, në përputhje me nevojat e institucionit.

Kontraktori duhet te paraqes:

- Raportim përmbledhës çdo javë për ecurinë e fushatave.

- Raportim final për shërbimin e promovimit, ku të përfshihen sugjerime dhe strategjia për promovimin për 6-mujorshin në vazhdim;

Kërkesat për kualifikim:

Kandidati/Ofertuesi me paraqitjen e tij pranë AK duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtëm:

1. Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.(bashkelidhur)

2. Formularin e ofertës të detajuar me cmime sipas tabelës së mësipërme.

3. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 100 000 leke të realizuara gjatë tre viteve të fundit. Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur vertetim për realizim kontrate ose faturën/faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

4. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

5. Deklarate nga ana e OE se ku të deklarojë se shërbimi i ofruar do të jetë sipas specifikimeve të kërkuara më lart si dhe për periudhën deri me 31.12.2020 sipas kërkesave të institucionit.

6. Deklarate nga ana e OE se ku të deklarojë se garanton përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës:

-Ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurinë e të dhënave për aksesin në rrjetet sociale të FSHZHD;

-Se nuk do t'i shpërndajë me palë të treta të paautorizuara të dhënat e FSHZHD;

-Se nuk do të ndërhyjë, modifikojë, fshijë, tjetërsojë materialet apo informacionet ekzistuese në rrjetet e FSHZHD;

7. Subjekti i klasifikuar i pari ne renditje duhet te kontaktoje me autoritetin kontraktor brenda nje dite nga klasifikimi i ofertes, shpallja e fituesit dhe kontaktimi me Autoritetin Kontraktor, *(per cdo paqartesi mund te kontaktoni per sqarim)*.
8. Dokumentat duhet te jene te printuara nga sistemi E-albania, origjinale ose te noterizuara.
9. Ne oferten e tij, ofertuesi duhet te paraqese te dhenat e plota te personit te kontaktit.

Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në “Ftesën për Ofertë, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në “Ftesën për Ofertë”, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ARIAN LECO

KOMISIONI I PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL

Vjollca Vasiari, Kryetar

Megi Mulita, Anetar

Jona Bebeci, Anetar

tirananeWS.al